

## THIRRJE PËR SHPREHJE TË INTERESIT

REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT  
PROJEKTI PËR EFIKASITET ENERGJETIK NË SEKTORIN PUBLIK  
(IBRD 9038MK)  
NUMRI I IDENTIFIKIMIT TË PROJEKTIT: P149990

### MK-MOF-002-2021-CS-CQS

#### LOT 1

#### **ASISTENCË TEKNIKE: PËRGATITJA E RAPORTEVE TË HOLLËSISHME PËR KONTROLL ENERGJETIK, PROJEKTEVE TË HOLLËSISHME ME SPECIFIKIME TEKNIKE PËR RINOVIME EFIKASE ENERGJETIKE TË NDËRTESAVE DHE REVIZIONI TEKNIK**

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut mori hua nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim - Banka Botërore për zbatimin e Projektit për efikasitet energjetik në sektorin publik. Pikësynimet lidhur me zhvillimin e projektit janë: (i) reduktimi i konsumit të energjisë në sektorin komunal; dhe (ii) përkrahja e zhvillimit dhe zbatimit të mekanizmit të qëndrueshëm të financimit të efikasitetit energjetik në sektorin publik. Qëllimi i projektit është që të arrihen këto pikësynime duke mundësuar investime në ndërtesat e pushtetit (lokal) komunal dhe (qendror), si dhe duke shfrytëzuar burime të ripërtërishme të energjisë. Sipas kushteve të marrëveshjes, synohet që një pjesë e mjeteve të destinohen për sigurimin e asistencës teknike për përgatitjen e raporteve të hollësishme për kontroll energjetik, projekteve të hollësishme me specifikime teknike për rinovime efikase energjetike të ndërtesave dhe revizionin teknik.

Shërbimet konsulente parashikojnë që konsulenti të përgatisë raporte të hollësishme të kontrollit energjetik, të përgatisë projekte të hollësishme me specifikime teknike lidhur me rikonstruimin efikas energjetik në ndërtesat e shëndetit publik në bazë të raporteve të hollësishme të kontrollit energjetik, duke përfshirë fazat arkitektonike, ndërtimore, termoteknike, mekanike, elektrike dhe specifikimet teknike; dhe të vlerësojë kostot dhe përlllogaritjet (BoQs), si dhe të parashtrijë revizion teknik të projektit të hollësishëm. Konsulenti po ashtu do t'i identifikojë rreziqet ekologjike dhe sociale lidhur me punët e planifikuara për rikonstruim dhe do të përgatisë plane për menaxhim me mjedisin jetësor dhe punën sociale, si dhe lista për kontrollin e tyre. Informacione më të hollësishme në lidhje me kualifikimet e nevojshme mund t'i gjeni në këtë link: [https://finance.gov.mk/proekt\\_za\\_energetska\\_efikasnost/](https://finance.gov.mk/proekt_za_energetska_efikasnost/).

Ministria e Financave u bënë thirrje kompanive të kualifikuara konsulente ("konsulentëve") të shprehin interes për sigurimin e shërbimeve. Konsulentët e interesuar duhet të parashtrijë informacione me të cilat do të dëshmojnë se i posedojnë kualifikimet e nevojshme dhe përvojën relevante për ofrimin e shërbimeve. Konsulentët në fjalë, duhet t'i plotësojnë kriteret në vijim:

#### Përvoja dhe kualifikimet e konsulentit

Konsulenti duhet të jetë kompani konsulente me përvojë relevante në projekte. Punën duhet ta ndërmarrë ekip i konsulentëve i përbërë nga ekspertët të cilët posedojnë aftësitë dhe ingerencat në vijim:

#### 1) Kapacitet ekonomik dhe financiar të konsulentit

Qarkullimi mesatar vjetor i konsulentit duhet të tejkalojë 150.000 euro për 3 vitet e fundit financiare (vitet 2019, 2020 dhe 2021)

#### 2) Aftësi profesionale të konsulentit

Kritere për personat juridikë dhe fizikë:

- Personi juridik duhet të posedojë licencë të vlefshme për kryerjen e kontrollit energjetik të lëshuar nga Ministria e Ekonomisë e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

- Personi juridik duhet me sukses të ketë realizuar të paktën 3 marrëveshje për shërbime lidhur me projektimin e mbindërtimeve me efikasitet energjetik.

Personi juridik duhet të posedojë licencë të vlefshme A për projektimin e kompanisë, të lëshuar nga Ministria e Transportit dhe Lidhjeve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

- Së paku 10 persona të punësuar që punojnë për konsulentin.

Punën duhet ta ndërmarrë ekipi i konsulentëve i përbërë nga ekspertë sipas aftësive dhe kualifikimeve të mëposhtme. Ekipi do të përbëhet prej së paku 7 ekspertëve kryesorë të punësuar nga Konsulenti dhe përkrahet nga ekipi ndihmues i përbërë nga ekspertë me përvojë, më të rinjë dhe jo kryesorë.

Konsulentët mund të bashkëpunojnë me kompani të tjera si sipërmarrje e përbashkët (joint ventures) ose si nënkonsulentë me qëllim që t'i përmirësojnë kualifikimet e tyre. "Asociacioni" mund të jetë në formë të sipërmarrjes së përbashkët ose të zyrës nënkonsulente. Në rast të sipërmarrjes së përbashkët (SP), të gjithë anëtarët e SP-së së bashku do të vlerësohen për qëllimet e listës së shkurtër dhe do të jenë përgjegjës në mënyrë të përbashkët dhe individuale për detyrat dhe do ta nënshkruajnë marrëveshje në rast të ofrimit të tyre për sipërmarrjen e përbashkët (SP). Konsulentët e interesuar duhet qartazi ta cekin strukturën e "asociacionit" të tyre dhe detyrat e partnerëve dhe nënkonsulentëve në aplikimin e tyre.

Mënyra e paqartë e shprehjes së interesit në aspekt të formave "në bashkëpunim me" dhe/ose "në lidhje me" dhe të ngjashme nuk mund dhe nuk do të merren parasysh për listën e shkurtër. Si parim, duke pranuar një shprehje interesi për kompani, kompania konsulente duhet të vendosë nëse dëshiron të marrë pjesë si nënkonsulent ose si konsulent individual, apo si partner i sipërmarrjes së përbashkët (SP). Ju lutemi të merret parasysh se kompania duhet të parashtrijë vetëm një shprehje interesi në procesin e njëjtë të përzgjedhjes ose veçmas si konsulent ose si partner i sipërmarrjes së përbashkët. Asnjë kompani nuk mund të jetë nënkonsulent përderisa parashtron shprehje interesi veçmas ose si partner i sipërmarrjes së përbashkët (SP) në procesin e njëjtë të përzgjedhjes. Kompania, nëse vepron në cilësinë e nënkonsulentit me çfarëdo konsulenti apo sipërmarrje të përbashkët (SP), atëherë mund të marrë pjesë me më shumë konsulentë, por vetëm në cilësinë e nënkonsulentit.

Për informacione shtesë mund të drejtoheni në adresën e mëposhtme gjatë orarit të punës nga ora 8:30 – 16:30, nga e hëna deri të premtën.

Shprehja e interesit duhet të parashtrijet në formë të shkruar në adresën e mëposhtme (personalisht, përmes postës ose email-it) më së voni deri më datë **10 gusht të vitit 2022 në orën 16:30**.

Ministria e Financave  
Projekti për efikasitet energjetik në sektorin publik  
Rr. Dame Gruev, nr.12, 1000 Shkup  
Republika e Maqedonisë së Veriut

Drejtuar z. Aleksandar Najdovski, MSIP – EIP

Tel/faks: ++ 389 2 3120352  
[Aleksandar.Najdovski@finance.gov.mk](mailto:Aleksandar.Najdovski@finance.gov.mk)